

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
INFINITY PROCUREMENTS

Në Tiranë sot më datë 08/01/2021 (dymijë e njetete e nje), themeluesi,

Znj.Najada Reçi, lindur më 16/12/1977 në Tirane dhe banuese ne Tirane, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtëse e Leternjoftimit me numer 035695665 dhe numer personal H76216046E, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

E cila duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, 'Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare', ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte "Shoqeria"), me dispozitat e mëposhtme.

Neni 1

Emërtimi dhe selia e shoqërise

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësai të kufizuar është: **INFINITY PROCUREMENTS**
Selia e shoqërise **INFINITY PROCUREMENTS** do te jete: Rruga: "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 5, Zyra S5, Tirane, Shqipëri. Në këtë adrese ndodhet edhe Zyra Qëndrore e Shoqërise.

1.1 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Reublikës së Shqipërisë.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

2.1 Objekti i Shoqërisë është:

- Konsulence për pjesëmarrje në tendera publike, hartim dhe plotësim dokumentacioni deri ne fazën e depozitimit te ofertës (elektronikisht dhe/ose ne hard copy) pranë Autoritetit Kontraktor publik ose jo, si dhe ndjekja e te gjitha fazave te ankimimit ne rast te skualifikimit nga procedura;
- Pjesëmarrja dhe hartimi i projekteve të ndryshme;
- Përgatitja e Due diligence-ave;
- Këshillime Ligjore;
- Vleresim pasurish te palujtshme nga Ekspert vlerësues te shkalles se Pare;
- Siguracionet (Shoqëri Sigurimi –Shtet, Shoqëri Sigurimi –Person Fizik ose Juridik. Person Fizik ose Juridik - Shoqëri Sigurimi);
- Përpilim kontratash. Rregjistrim Shoqërisht Tregtare dhe OJF-ve;
- Këshillime Ligjore administrativo- civile;
- Konsulencë ligjore (për të gjitha shkallët e gjykimit): për çështje të ndryshme administrative, civile, tregtare apo penale, konsulencë dhe asistencë në fushën e investimeve të të gjitha llojeve, konsulencë dhe asistencë për themelimin e shoqërive,

administrimin e shoqërive, si dhe përgatitjen e të gjitha akteve përkatëse, ndërmjetësim, konsulencë në fushën e ndërtimit dhe fushën e manaxhimit të të gjitha të drejtave në lidhje me pasuritë e paluajtshme, konsulencë projektimi;

- Pjesëmarrja në projekte të ndryshme, përgatitja e Due diligencave për persona fizike dhe/ose juridik.
- Asistenca juridike në kuadër të procedurave për dhënien në konçesion dhe procedurat e privatizimit;
- Restaurim objektesh të trashgimnise kulturore;
 - Veprimtari të tjera të lejuara me ligj.

Aktiviteti i shoqërise nuk do të kufizohet vetëm në këto shërbime apo veprimtari.

2.2 Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara mund të bashkëpunojë me direkt dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog osë të lidhur me të tyren.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërise. Viti ushtrimor

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.

3.2 Viti i parë financiar do të fillojë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.

3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë me 31 Dhjetor

Neni 4

Kapitali themeltar

4.1 Kapitali themeltar u nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë leke) dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Kapitali themeltar ndahet në 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë prej më vlerë prej 10.000 (dhjetë mijë) Lekë.

4.2 Në bazë të kontributit të paguar, pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar është Z.Najada Reçi. zoteron 100% të kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuote.

Neni 5

Asambleja e Përgjithshme

5.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e përcaktuara në Ligjin për Shoqëri tregëtare . Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet dhe sipas mënyrës së thirrjes të përcaktuara në statusin e shoqërisë.

Neni 6

Administratori

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Z.Najada Reçi.. Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 7

Kostot e themelimit

7.1 Të gjitha kostot, pagesat dhe shpenzimet lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë do të merren përsipër nga shoqëria të cilat do të përfshihen në llogarinë e parë vjetore financiare në shumën e atyre aktuale.

Neni 8

Njoftimet

8.1 Njoftimet për oratakët do të kryhen me postë të regjistruar në adresën e kompanisë më të fundit të komunikuar nga çdo ortak, me përjashtim kur parashikohet ndryshe nga ligji apo statuti.

8.2 Njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike, në momentin e krijimit të ksuhteve teknike që kërkohen sipas ligjit.

Neni 9

Dispozita të fundit

9.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë, akt themelimi, me statutin e saj, me objektin dhe ligjin shqiptar.

Neni 10

Te tjera

10.1 Ky akt themelimi hartohet në 3 kopje, një kopje orataku, një kopje për Qendrën Kombetare të Biznesit dhe një kopje për zyrën Qëndrore të Shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
INFINITY PROCUREMENTS**

Zj. Najada Reçi.

